

V E N D I M
Nr.249, datë 24.4.2003

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR LEJE MJEDISORE DHE TË
ELEMENTEVE TË LEJES MJEDISORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 37 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, për t’u pajisur me leje mjedisore, paraqesin kërkesën për miratimin e projektit ose të veprimtarisë që do të ushtrojnë dhe dokumentacionin shoqërues, të përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Kërkesa paraqitet në agjencinë rajonale të mjedisit të qarkut, ku do të ushtrohet veprimtaria.
 3. Leja mjedisore përmban elementet, kërkesat dhe kushtet që jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
 4. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Aneksi 1

Dokumentacioni i domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore

1. Kërkesa e personit fizik ose juridik drejtuar Ministrisë së Mjedisit për miratimin e projektit dhe për t’u pajisur me leje mjedisore.
2. Përshkrimi i projektit ose veprimtarisë që trajton:
 - a) Karakteristikat e projektit:
 - i) përshkrimi i proceseve kryesore, teknologjia, kapaciteti, lëndët e para, lëndët ndihmëse, produktet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare;
 - ii) program pune për ndërtimin dhe shfrytëzimin;
 - iii) aktivitete të tjera që mund të kërkohen si pasojë e projektit (p.sh. rrugë të reja, sigurimi i ujit të pijshëm etj.).
 - Vendndodhjen e projektit:
 - i) planimetria me kufijtë e projektit;
 - ii) harta dhe fotografi që tregojnë vendndodhjen e projektit;
 - iii) planet ekzistuese të përdorimit të territorit ku zhvillohet projekti.
 - Ndikimet e mundshme në shëndet dhe mjedis:
 - i) ndikimet në shëndetin e njerëzve, në florë dhe faunë, në tokë, ujë dhe ajër, në klimë dhe peizazh, në trashëgiminë kulturore dhe historike;
 - ii) natyra e ndikimeve (direkte, indirekte, të përhershme, të përkohshme, pozitive, negative);
 - iii) masat për zbutjen e ndikimeve në mjedis;
 - iv) ndikimet me natyrë ndërkuftare.
3. Vendimi i gjykatës për regjistrimin e kërkuarit si person fizik ose juridik.
4. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis i hartuar nga persona fizikë e juridikë të certifikuar e të zgjedhur nga kërkuari i lejes mjedisore.

Aneksi 2

Elementet që përmban leja mjedisore

1. Emri i Ministrisë së Mjedisit si autoritet që lëshon lejen mjedisore për veprimtari të që ndikojnë në mjedis.
2. Emri, adresa e personit fizik ose juridik që i jepet leja mjedisore.

3. Referenca ligjore që mbështet dhënien e lejes mjedisore.
4. Detajimi i kushteve për respektimin e normave të shkarkimeve në çdo nyje shkarkuese të veprimtarisë dhe në total, duke i cituar normat e shkarkimeve.
5. Kërkesat për zbatimin e programit të monitorimit duke përfshirë treguesit e gjendjes, të ndikimit, stacionet e marrjes së mostrave dhe frekuencën e matjes së tyre, metodën e matjes ose të llogaritjes, formatet e paraqitjes dhe të regjistrimit të të dhënave.
6. Përcaktimi i masave për uljen e konsumit të lëndëve të para, të ujit e të energjisë dhe për përmirësimin e teknologjisë sipas një programi.
7. Detyrimi për të dorëzuar një herë në tre muaj të dhënat e monitorimit në agjencitë rajonale të mjedisit të qarkut dhe për t'i publikuar ato një herë në vit.
8. Përcaktimi i masave dhe afatet për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar ose të ndotur.
9. Masat për trajtimin e mbetjeve dhe mbetjeve të rrezikshme që krijon veprimtaria.
Masat e detyrueshme restauruese në rast mbylljeje të veprimtarisë.
11. Afatet për përtëritjen e lejes mjedisore, si dhe të skadimit të saj, kur veprimtaria nuk fillon të ushtrohet.
12. Detyrimi për kryerjen e vlerësimit mjedisor.
13. Detyrimi për zbatimin e kërkesave të lejes edhe kur veprimtaria kalon në pronësi ose përdorim të një personi tjetër.
14. Sanksionet në rast mosrespektimi të kushteve të lejes mjedisore.
Tarifa e lejes mjedisore.
Data e hyrjes në fuqi e lejes.